

VENDIM
Nr. 88, datë 7.6.2017

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SHOQËRISË
“LENGARICA & ENERGY” SHPK, NË FAVOR TË BANKAVE “GREEN FOR
GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE SA (GGF)” DHE “OESTERREEICHISCHE
ENTWICKLUNGBANK AG (OEEB)”**

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 7 dhe 11 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 99, datë 17.6.2016 të bordit të ERE-s, gjithashtu dhe neni 15 i “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., për lënien peng të aseteve në favor të bankave “Green For Growth Fund Southeast Europe S.A(GGF)” dhe “Oesterreeichische Entwicklungsbank AG (OeEB)”, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

ERE, me vendimin nr. 143, datë 15.8.2016, ka filluar procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k. për lënien peng të aseteve në favor të bankave “Green For Growth Fund Southeast Europe SA (GGF)” dhe “Oesterreeichische Entwicklungsbank AG (OeEB)”.

Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit” si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat:
 - “a” Ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit, është plotësuar.
 - “b” Veprimtaria e licencuar është plotësuar.
 - “c” Gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve, është plotësuar.
 - “d” Përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare, është plotësuar.
 - “e” Arsytet e kërkesës për kryerjen e transferimit, është plotësuar.
 - “f” Efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit, është plotësuar.
 - “g” Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar, është plotësuar.
 - “h” Marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji për transferimin e aseteve. Marrëveshja përmban një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen, është plotësuar.
 - “i” Deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit, është plotësuar.
 - “j” (Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt) është e paplotësuar.
- Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k. për lënien peng të aseteve në favor

të bankave “Green For Growth Fund Southeast Europe SA (GGF)” dhe “Oesterreeichische Entwicklungsbank AG(OeEB)” (lista bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

ASETE TË SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SHPK PËR LËNIEN PENG NË FAVOR TË BANKAVE “GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE SA (GGF)” DHE “OESTERREEICHISCHE ENTWICKLUNGBANK AG (OEEB)”

(I) Një digë ujëmbledhëse me gjerësi 100 m x 20 m trashësi prej betoni, duke përfshirë një portë dalëse dhe dy portat hyrëse.

(II) Një desandër, 1300 m² total dhe gjatësi 96 m, mure të izoluar me perimetër 220 m, përfshirë edhe 6 porta hyrëse dhe 3 porta dalëse.

(III) Një kanal ujëmbledhës me një gjatësi 100 m x 3.7 m gjerësi x 3.1 m thellësi, përfshirë aksesin në kanal prej 26 m.

(IV) Një tunel me gjatësi totale 4000 m dhe pamje mesatare 11 m².

(V) Një pellg ballor prej betoni rreth 150 m³, duke përfshirë një portë dalëse dhe një portë emergjente.

(VI) Një tubacion (GRP), me gjatësi 1 220 m, me diametër 2.4 m; tubacion me gjatësi 1250 m, me diametër 2.2 m dhe një tubacion me gjatësi 1200 m, me diametër 2 m.

(VII) Një godinë centrale me sipërfaqe rreth 220 m², duke përfshirë të gjitha pajisjet elektrike dhe elektromekanike, që përfshijnë 2 turbina, 3 gjeneratorë, 2 valvula gj, një sistem që anashkalon me një valvul, kompartimentet e tensionit të lartë, tensionit të ulët dhe sistemin e kontrollit.

(VIII) Një kanal uji me rreth 981m gjatësi dhe 14 m gjerësi, bërë me beton.

(IX) Një lidhje në rrjet e përbërë nga 2 kabllot e energjisë, një transformator TM/TL 110 kV dhe një N/st komutimi (vendi dhe zona do të përcaktohen gjatë punimeve).